



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:031941

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474837

C. nr.35/2023

Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditësve R. G.dhe A.G. që të dy nga fshati S.Komuna e Klinës të përfaqësuar nga avokat Agron Kryeziu nga Malisheva, dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve "PRISIG", me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, jashtë shqyrtimit kryesor me datë 19.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR Padia e paditësve R. G.dhe A.G. që të dy nga fshati S.Komuna e Klinës, e ushtruar me datë 03.02.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "PRISIG", me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material.

A r s y e t i m

Paditësit e lartpërmendur, të përfaqësuar nga avokat Agron Kryeziu, nga Malisheva, në këtë gjykatë me datë 03.02.2023, kanë parashtruar padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurës të lartcekur për kompensim të dëmit material dhe jo material.

Paditësi nëpërmjet të autorizuarit të tij avokat Agron Kryeziu, me datë 14.12.2023, përmes parashtrësës për tërheqjen e padisë e ka informuar gjykatën se paditësit me të paditurën Kompania e Sigurimeve "PRISIG", me seli në Prishtinë, kanë arritur që këtë çështje për kompensimin e dëmit material dhe jo material ta mbyllin me marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj pasi që paditësit me të paditurit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore paditësit e tërheqin padinë pasi që e kanë realizuar kërkesën për dëmshpërblim.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës konform nenit 261 paragrafi 1, 3, 4 dhe 5 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë.
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C. nr. 35/2023, datë 19.03.2024.**

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.